



Pranuar / Dorezuar Punimjen / Profuturo Received / Delivery	13.06	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKENSHACK	3446/2022		1/3	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.438/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti- kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca - anëtar dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.438/2022 të datës 04.05.2020 të parashtruar nga ankuesja _____ me adresë _____ kundër organit të punësimit/Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 13.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.438/2022 e datës 04.05.2020, e parashtruar nga ankuesja _____

A r s y e t i m

Ankuesja _____ ka qenë e punësuar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Skënderaj, sipas akt emërimit me numër 03 112-575 të datës 28.12.2012, në pozitën “Sekretare juridike”. Me datën 29.07.2019, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër të referencës DS-189/2019 sipas të cilit ankueses i ka përfunduar marrëdhëniet e punës me rastin e pensionimit dhe që sipas këtij vendimi e njëjta ka gëzuar të drejtën e një page shtesë më rastin e pensionimit.

Me datën 20.12.2021, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër DS-688/2021 sipas të cilit e ka refuzuar kërkesën e ankueses lidhur me pagesën e një page përcjellëse dhe tri pagave jubilarë pas pensionimit.

Me datën 24.02.2022, ankuesja ka parashtruar ankesën më numër të protokollit 394 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të

Kosovës lidhur me pagesën e tri pagave jubilarë dhe realizimin e pushimit vjetor në formë monetare.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datën 22.03.2020 ka nxjerrë Vendimin me numër KA.nr.09/2022, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar me arsyetimin se në bazë të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil për Shërbimin Civil të Kosovës e njëjta është kompensuar me një page përcjellëse me rastin e pensionimit, ndërsa sa i përket kërkesës së ankueses lidhur me shndërrimin e pushimit vjetor në vlerë monetare është përgjigjur se në bazë të Rregullores Nr.06/2011 për Pushimet e Nëpunësve Civil pushimi vjetor nuk mund të shndërrohet në formë tjetër të kompensimit monetar ose jo monetar.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin KA.nr.09/2022 të datës 22.03.2022 të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datën 28.04.2022 përmes Postës së Kosovës ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 2571/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në këtë institucion është pranuar me datën 04.05.2022, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljes së ligjit të punës dhe ligjit për shërbyesit civil dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:

Ankesën me numër protokollit 25715/2022 të datës 04.05.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KA.nr.09/2022 të datës 22.03.2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesën e ankueses të datës 20.12.2021 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 11.05.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 26.05.2022 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimin me numër DS-189/2019 të datës 29.07.2019 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës së ankueses me rastin e pensionimit; Ankesën e ankueses të datës 24.02.2022 për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Akt emërimit të ankueses me numër 03 112-575 të datës 28.12.2012; Vendimin me numër DS-688/2021 të datës 21.12.2021 nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Shkresën zyrtare të datës Nr.03/2032 të datës 21.12.2021; Flet kthesën e datës 19.01.2022; Flet kthesën me numër 09/531 të datës 28.03.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është e pa lejuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka administruar provat e lëndës lidhur me afatshmërinë e ankesës së ankueses, të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka konstatuar se: ankuesja Vendimin me numër KA.nr.09/2022 të datës 22.03.2022 i nxjerrë nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, në bazë të dëshmisë se shkresave të lëndës del se e ka pranuar me datën 28.03.2022 sipas fletë kthesës me numër 09/531 të datës 28.03.2022. Ankuesja me datën 28.04.2022 e ka parashtruar ankesën e saj në Këshill përmes Postës së Kosovës, mirëpo është pranuar me datën 04.05.2022, që në bazë të nenit 81 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative të njëjtës i ka rrjedhur afati për ankesë ditën e nesërme. Në bazë të provave të lëndës dhe llogaritjes



së afatit kalendarik, del se ankuesja ankesën e saj ne Këshill e ka parashtruar në ditën e tridhjetë e një (31) pra me datën 28.03.2022 ,e që është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se : *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve , nga data kur është njoftuar për aktin administrativ"*, sepse afati kalendarik për parashtrimin e ankesës prej tridhjetë (30) ditësh i ka përfunduar me datën 27.03.2022, e që në bazë të llogaritjes sipas të njëjtit del se data 27.03.2022 nuk ka qenë ditë pushimi, andaj në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesa e ankueses është e pa lejuar.

Andaj, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda,A.nr.438/2022, datë 13.06.2022

Ardita Përcuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

